



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	29.01.2021
Referenc-ë:	07-353/04-15915/21
Për/ Za/ To:	“Zero Pozitive”SH.P.K
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoll 07-353/04-15915/21 nga “Zero Pozitive”SH.P.K me përfaqësues Jon Dedinca i cili kërkon shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Ibrahim Rugova”me datat 12,13 dhe 14 Mars 2021 nga ora 16:00 deri në 18:30.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike me datat 12,13 dhe 14.02.2021 në Sheshin “Ibrahim Rugova”.

Gjatë aktivitetit DJ do të performojë muzikë si dhe do të ketë lojëra ku qytetarët do të mundën të fitojnë dhurata.

Në aktivitet nuk lejohet promovimi i duhanit, ngase është e ndaluar në bazë të nenit 6.25 të rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01nr.110-2782.

Kushtet e pëlqimit:

- organizatori obligohet që të siguroj respektimin e plotë të gjitha masat e parapara nga IKSHPK për organizime të tilla në kohë pandemie. Organizatori obligohet që të siguroj dhe të monitoroj gjatë gjithë kohës së këtij organizimi që numri i pjesëmarrësve të jetë i kufizuar, të ketë distancë të mjaftueshme, secili pjesëmarrës ti bart masat mbrojtëse si dhe masa tjera të përcaktuar nga IKSHPK për mbrojtje nga COVID.

- varësisht nga vendimet e IKSHPK-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

